



Mësimi 3

Roli i Algoritmeve dhe Mediave Sociale

Koha për përgatitje: **30 minuta**

Kohëzgjatja e modulit: : 1 x 60 minuta

Abstrakt

Ky modul shqyrton rolin e algoritmeve të mediave sociale në formësimin e përmbajtjes që përdoruesit hasin në platformat digjitale. Algoritmet ndikojnë në shpërndarjen e gjithë informacionit online, përfshirë diskursin politik, dhe mund të kontribuojnë në përhapjen e keqinformimit. Pjesëmarrësit do të analizojnë se si këto algoritme krijojnë “flluska informacioni”, përforcojnë paragjykimet dhe ndikojnë në opinionin publik. Gjithashtu, moduli do të prezantojë strategji praktike për të njohur manipulimin algoritmik dhe për të larmishuar burimet e lajmeve, me qëllim përmirësimin e edukimit mediatik dhe mendimit kritik.

Burime edukative online

- Studime mbi ndikimin e algoritmeve në rrjetet sociale
- Mjete online për verifikimin e lajmeve
- Raste studimore mbi keqinformimin (zgjedhjet, COVID-19)

Fjalë kyçe

Algoritme, flluska informacioni, rrjete sociale, keqinformim, edukim mediatik, mendim kritik

Qëllimi i modulit

Qëllimi i këtij moduli është t’u ndihmojë pjesëmarrësve të zhvillojnë një kuptim kritik mbi mënyrën se si algoritmet e rrjeteve sociale formësojnë përmbajtjen që ata shohin dhe ndikojnë në perceptimin e tyre ndaj informacionit. Përmes këtij moduli, pjesëmarrësit do të mësojnë të identifikojnë paragjykimet në përmbajtjen që u shfaqet dhe të zhvillojnë strategji për të larmishuar burimet e informacionit që konsumojnë.

Rezultati i modulit

Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë se si funksionojnë algoritmet dhe rolin e tyre në formësimin e përmbajtjes në rrjetet sociale
- Analizojnë ndikimin e algoritmeve në diskursin politik dhe mënyrën se si ato ndikojnë në përhapjen e keqinformimit
- Njohin flluskat e informacionit dhe paragjykimet algoritmike

Procesi i zbatimit të modulit

Min. 1–5: Hyrje

- Filloni me një sondazh ndërveprues: “Si i zgjidhni lajmet që lexoni?” ose “A mendoni se rrjetet sociale ndikojnë në mënyrën se si e shihni një temë të caktuar?”
- Diskutim: Shfaqni pjesëmarrësve dy rrjete sociale të ndryshme (një me përmbajtje konservatore dhe një me përmbajtje liberale) dhe kërkon nga ata të hamendësojnë se si algoritmet mund të ndikojnë në atë që përdoruesit shohin ose cilët përdorues do t’i shohin ato përmbajtje.

Min. 6–20: Aktivitet ndërveprues

Tema diskutimi:

- Çfarë ndikimi kanë algoritmet në filtrat dhe përmbajtjen e rekomanduar në platforma si TikTok, Facebook, Twitter/X?
- Si ndikoi Twitter në zgjedhjet në SHBA dhe si ndikoi promovimi algoritmik i përmbajtjes në sjelljen e votuesve? Kërkimet tregojnë se mbi 50% e përdoruesve të Facebook-ut shohin vetëm përmbajtje që përputhet me bindjet e tyre, ndërsa vetëm 14,7% shohin rregullisht pikëpamje të kundërta.
- Aktivitet në grup: Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla dhe caktojuni secilit grup një skenar të ndryshëm algoritmik. Grupet analizojnë se si secili skenar do të ndikojë te përdoruesit dhe prezantojnë përfundimet e tyre.

Min. 21–50: Zbatim Praktik

- **Ushtrim:** Pjesëmarrësit do të hapin rrjetet e tyre sociale dhe do të shënojnë se cilat tema u shfaqen më shpesh. Diskutohet ndryshimi mes rrjeteve të pjesëmarrësve dhe si personalizimi ndikon në larmishmërinë e përmbajtjes.
- **Debat mbi ndikimin e algoritmeve:** “A duhet të rregullohen platformat e rrjeteve sociale për të parandaluar manipulimin?” “A ndihmojnë apo dëmtojnë algoritmet demokracinë?”
- **Ushtrim për verifikimin e fakteve:** Prezantoni pjesëmarrësit me mjete online për verifikimin e besueshmërisë së lajmeve. Pjesëmarrësit analizojnë artikuj të vërtetë dhe të rremë dhe përcaktojnë besueshmërinë e tyre.

Min. 51–60: Përfundimi

- Rikapitullim i pikave kryesore
- Diskutim reflektues: “Si mund t’ju ndihmojnë këto aftësi të orientoheni më mirë me informacionin online?”

Materiale / Mjete

Projektor video, laptop, lidhje interneti, pamje të ekraneve (screenshot) nga rrjete të ndryshme sociale, shembuj rastesh studimore, prezantim në PowerPoint ose Prezi, Canva.